

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-1
Ø 86.

KOSTAQ DUKA

THJESHTESI

POEZI

SH-1
886.

KOSTAQ DUKA

THJESHËSI

poezi



12.164

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtypur Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1976

PORTRETI I SHQIPËRISË

Portreti yt Shqipëri

nuk janë vetëm kurorat me agrume,

toka me pambuk dikur moçalishte,

shtatet e lartë të uzinave,

pallatet e lumturisë së punëtorëve.

Portreti yt

është fytyra e punëtorit, që s'iu nda 24 orë

makinës,

I tha: Ndal! bllokadës.

Është fytyra e kufitarit,

që mbi shpinë mbarti tokë,

në mal mbolli grurë,

Është fytyra e kufitarit,

nga të ftohtit i ngriu gjaku,

por syri s'ju mbyll kurrë.

Portreti yt Shqipëri,
është zemra rinore që rreh tek pleqtë
e thinjur.

Është gjoksi i zbukuruar me dekorata
i heronjve të punës,
lapidari i Qemalit, i Ademit, i Shkurtës,
janë ditët e qeshura të dy milioneve.

PËR MËMËDHENË S'HESHTI KITARA

Në netë të ftohta pushtimi,
befas për dashurinë heshti kitara.
Dritareve të vajzave,
s'trokisnin tingujt e ndjenjave të zjarrita.

E prapë,
diku të sigurtë, gishtrinjtë rrëshqisnin mbi tela.
«Për mëmëdhenë... për mëmëdhenë»
në prag muzgjesh të kuqëremta.

Për mëmëdhenë,
s'heshtën kitara,
për mëmëdhenë
sëmbon zemra.

«Për mëmëdhenë...»

dridhet plaku

«Për mëmëdhenë...»

malet janë pranë — djalit i zjen gjaku.

DUAJINI ATA SY, FËMIJË

Veterani i hequr, pak i kërrusur e ka
shkelur atë mal.

Dimri ka qënë i egër,
Në atë majë dëbore ja copëtoi gishtrinjtë,
tek mbante mbi shpinë një shok të plagosur,
sytë iu dëmtuan nga një minë.
Duajini ata sy fëmijë,
që sot mjegullën e muar për borë.
Puthini me dashuri,
ata sy,
që në shenjestrën e pushkës s'kanë
gabuar kurrë.

FJALA E PLAKUT BOROVAR NË DITËN E DJEGIES SË BOROVS

(*Miço Lazit*)

Flokëthinjur,
mbi një pirg gurësh të hirnosur Miçua
i fliste vehtes, të rënëve dhe botës:

Mjerimi
më flaku përtej deteve,
ndërtova pallate e faltore nëpër botë.
Rri rrëzë grataçielave
më rëndonte keq çekani e mistria në torbë,
më përlotëte sytë kujtimi i shtëpisë
së vogël, të gurtë në Borovë.

Këto vite të egra,
kur bota e gjithë digjet në flakë,
në fshatin e lindjes erdha.

Rinia ime,
është rrukullisur në kurrizin e dalë të pleqërisë.
Erdha,
çekanin, mistrinë e zemrën të prek një ditë në
plloçat
e gurta të shtëpisë.

Flokëthinjur,
mbi një pirg gurësh të hirnosur,
Miçua i fliste vehtes, të rënëve të botës,
ku je o plaka ime e urtë?
Flokëverdhët të rrethuan me flakë.
S't'u ndodha pranë,
kur ishte ende nuse,
s't'u ndodha pranë kur u thinje,
s't'u ndodha pranë kur më ike.

Flokëverdhët
të rrethuan me flakë,
se ishe nënë e trimave.
Në mal me djemtë partizanë,
kur u dogje na u prenë gjunjët,
vetiu gishtrinjtë u mblodhën grusht,
vetiu gishtrinjtë shkrepën pushkën.

Dielli doli mbi sup të Gramozit.
Plaku i thinjur,
mbi gurë të hirnosur si mbi shpinë të kohës
betohet:

Flakës me flakë,
që përsëri të kap mistri e çekanë
për brezat që vinë,
Borovën ta ngremë lapidar
të dhimbjes e lirisë.

ETËRVE TË THINJUR

Ende pa gdhirë,
ju hapni pa zhurmë portat e drunjta,
hidhni hapat e matur rrugëve të gurta.
E rrugët ngrohen nga romuze pleqërishte.
Në duar mbani,
torbën e thjeshtë, diku të arnuar,
torbën që me vite mbarti bukë e gjizë,
torbën veterane të punës.

Pa gdhirë!
Kështu i çelët portat, kur në rrugë kish errësirë:
pa gdhirë u nisët përtej deteve,
pa gdhirë drejt maleve dualët për lirinë.
Pa gdhirë mirë,
gjersa u thinjët çelët portat,
derdhët e derdhët djersë për Shqipërinë.

Q I L I M I

Katër qoshe,
katër vija.
Jeta mbyllej në kuadrat.
Me qilim krahët e hollë, të bardha,
mbi petalet sytë e lodhur
nga pagjumësia.

Katër qoshe,
katër vija.
Vajza rritej hidhte shtat,
lindnin, shuheshin dëshirat vajzërore
në këtë kuadrat

Katër vija,
katër horizonte.
Vajza me pushkën në sup,
derdhi gjak mbi qilimin e ashpër të maleve.

Katër qoshe,
katër vija.
Pranë litarit, duvakut të nusërisë,
qilimi në muze,
simbol i dhimbjes së vajzërisë.

Katër vija,
katër horizonte,
vajza shqiptare në botë,
më e lira ndër shoqe.

ATJE KU U TRETËN ËNDRRAT VAJZËRORE

(Me gjyshen në Lëndinën e lotëve)

«Bir,
dikur në këtë lulishte të bukur,
ende nuse e re unë u thinja papritur!...
Bir,
këtu i lenin djem mustaqe pa dirsur,
mbeteshin emra,
ktheheshin pleq të gërmuqur!...»

Për një çast,
m'u duk sikur lulet u nxinë,
u shndërruan në kryqe e eshtra,
eshtra që klithnin:
ja ku jemi, gëzohuni, s'kemi humbur!

Vështroj fytyrën e reshkur,
vështroj flokët e thinjur,

gjyshja ngadalë këndon një këngë të hidhur.
«Bir,
i qamë njerëzit që të gjallë,
po e hëngri çairen ajo kohë flamë!»...

Prej flokëve të gjyshes ra shami e zezë,
për të këputa një zambak të bardhë.

VAJZA E PIKTORIT

Në studion e piktorit,
sytë e Majlindës treten ndër piktura.
Me gishtrinjtë e hollë diellin prekin lehtë,
me hënën motërzë,
çdo natë nis një dialog të fshehtë.

Ulet në lëndina,
duart e vockëja zhyt në ujë burimi,
lëkunden degët e pemëve të njoma.


Mes drurëve të moçëm lodhet së ecuri,
në ditë me diell, në netë me yje,
i thotë vëhtes: vajzë e pyjeve.

Hipën në skela,
punëtorëve u shpupuris flokët, i përçafon,

ka shoqe të mira Shpresën tornitore,
Verën artiste.

Shpesh bie në mendime,
ç'të bëhem balerinë apo tekstiliste?

Në studio,
sytë e Majlindës treten ndër piktura,
fantazia kapër xen beze e ngjyra,
nëpër dhomë si fluturza ëndrat e bukura.



12104

TË DY SHTEGËTARË

Mbetet shpesh e vetmuar,
dhoma jonë përballë Dajtit.
Thonë fqinjët:
Sa keq u thanë lulet në ballkonin e gazetarit.

Pas shërbimit,
(malli më ka plasur mbi buzë)
kthehemi në dhomën e bardhë.
Nga supet e mia halat e pishave
bien mbi dyshemenë e larë.

Era e rivierës,
përhapet nga flokët e tu të verdhë.

Ulemi,
në tryezën e shkrimit,
në sytë e mi pishat, pëllëmba e reshkur e
druvarit,
në sytë e tu deti,
buzëqeshja e ngrohtë e peshkatarit.

TË KA ARDHUR NËNA!

Godina,
kumboi nga dhjetra zëra:
— Zbrit të ka ardhur nëna!
Një mendim të trishtuar braktisa,
kapërxeva tre katër shkallë, më dridhej
zemra.

Në këtë qytet rinor,
dëgjohet fjala shok, vajzë, motër, vëlla
dhe rrallë fjala nënë, gjyshe, baba.

Dhe ja flokëthinjura,
e imja, e urta, pakëz e hutuar, me sy,
të gëzuar.

Nënë!
— Bir! Ja edhe unë erdha në këtë
qytetin tuaj,
tha me një zë të dridhur si për t'u çfajësuar.

M B R È M È

Mbrëmë,
ra një shi i rrëmbyer pranveror,
mbi barin e njomë, stolat, asfaltet.

Mbrëmë,
u derdh më shumë ujë në fletët e turbinave
dhe vura re se drita qe më e bardhë.

Mbrëmë,
i lagu flokët, buzët, sytë,
shiu i pastër i ndjenjave të mia.

Si kujtove ti,
rrëkezat e kulluara
nuk mund të mbartin
një lumë të tillë dashurie?

FJALA E SHOQES SIME PËR BUZËQESHJEN

Jam 25 vjeçare,
mbi flokët e verdhë s'mund të ve,
shiritin si ylber të fëminisë.
Hënën s'mund ta bëj shoqe,
s'qaj e s'bërtas,
që britmën time ta dëgjojnë të gjithë.

E prapë,
nga ajo rrjedhëz çamaroke,
dua të ruaj një vijës të dliurë,
edhe e mplakur dhe e thinjur,
do të qesh e çiltër si fëmijë.

MOS HARRONI KËNGËN E ZOGJVET

(Nxënësve fshatarë të Shkollës së Mesme të Kulturës)

Ju rrini ulur para pianove,
si para portës së bardhë të ëndrrave.

Gishtrinj të tuaj të hollë,
vazhdim i gishtrinjve me kallo të etërve
fshatarë,

gishtrinjtë të lehtë si zogjtë,
gishtrinjtë si bisqet e njomë.

Ju rini ulur para pianove,
si para portës së bardhë të ëndrrave.

Tingujt në fushën e pianos-lule,
meloditë — tufëza të njoma të kuqe.

Nesër do të jini artistë.
Mos harroni,
ëndrrat tuaja mbinë nën foletë e zogjve!
Mos harroni,
buqetat e melodive t'i lidhni
me fillin e këngës së fyejve!

NËNA PARTIZANE

Dielli në të tretur...
E vogël, e mardhur,
dukej në të ardhur.
E rëndë buka mbi supet e mplakur.
Gëlltit dhimbjen në kokrra loti të hidhur.

— Më falni u vonova!
Djali partizan,
për një natë mbrëmë më erdhi.

Era i rrëmbeu shaminë.

Krenare ajo nënë,
rritej në të ikur
derdhur borës së bardhë,
flokët e thinjur.

E QESHURA E HIDHUR

(*Testa Tashkos*)

Skulptori,
vendosi mbi piedistalin e duarve kokën
e vet befaz u shndërrua në një skulpturë
nervoze.

Shqetësimi për jetën duhej nderur,
mbi të qeshurën, sytë, ballin e ndritur.

— Përse nuk baltove zemrën time?
Fytyra ime pas koncertit më e qeshura
ndër fytyrat vajzërore të botës,
kur mes jonesh të dridhura melodish,
zhyteshin fytyrat e ashpra të njerëzve,
fytyra ku një rreze gëzimi,
shpërthente papritur mes dhimbjes.

Përse nuk baltove zemrën time?
Tani e ke vështirë,
mbi profilin tim,
mbi të qeshurën,
të nderësh hidhërimin.

FJALË PËR BABANË PUNËTOR

Babai im është punëtor,
universiteteve pedagogji s'ka studjuar,
por s'ka harruar të më thotë,
se duart me kallo puna ja ka ashpërsuar.
Pesë vjeç,
kam parë si ai me shokë malin gëlqeror
ka rronitur me duar.
Kam parë fytyra të zbardhura,
ku sytë qeshnin si prush i pashuar.

Babai im është punëtor
universiteteve pedagogji s'ka studiuar,
por s'ka harruar në trupin e tij të më tregojë
dy plagë.

Kujton ditën,
kur beu e goditi me kamxhik atë, jetim
12-vjeçar,
kujton ditën,
kur me vëllezër, nënë e babë u bë në mal.

KUR QEP NGJYRAT E NDEZURA

(Nënës rrobaqepse)

Në fëshfërimën e fustaneve,
në dridhjen e zërit, të buzëve, në skuqjen e faqeve
ti ndjen rritjen e vajzave.

Dikur ke qepur dhe çitjane,
sot gëzohesh për dashuritë,
kur qep ngjyrat e ndezura.

Në moshën e zbardhjes së flokëve,
je mes shpërthimit të pranverës vajzërore.

E U F O R I A

Euforia,
ndjenja të fryra,
avuj të parfumuar
balona shumëgjyreshe në qiellin e vetvehtes.

Euforia,
kënaqësi dehëse,
paralizë shpirtërore e shndërruar në një qeshje
të ngrirë
helm që mbin aty ku s'ka luftë, aty ku ka
prehje.

ME RROBEN E BLERTË PARA FAMILJES

Para babait, nënës, gjyshes,
unë dhe motra veshur me rroba ngjyrë bari.
Në dhomë mbi krahët e lehtë kënga:
Dalongadal po vjen behari...

Babai pa vehten të rinuar...
Opinga grisur,
pantallonat të arnuara,
kapela me yj të qëndisur.

Nëna,
tek motra pa vehten 18-vjeçare...
Mbi flokët e zes kapela i rrinte e madhe.
— U marros bija e Taqos —
thosh në mëhallë një llafazane.
— Ç'të duhen, moj ditëzezë, ato male?

Lufta është për burrat,
gratë janë për magje.

E mallëngjyer gjyshja e mirë...
Çdo natë në shtëpi flinin ilegalë,
ja, tek ai krevati i drunjtë,
dhe tek ai tjetri përballë.
Mua s'më zinte gjumi,
djali kur do të më kthehet vallë?

Para babait, nënës, gjyshes
unë dhe motra nën rroben ngjyrë bari.
E ngrohtë nëpër dhomë kënga:
— Dalngadal po vjen behari.

BUZË DETIT PRANË DASHURISË

Cili skulptor,
mes ujërash të trazuara, të ftohta, nervoze
gdhendi buzët, flokët, sytë e saj?
Vallë pak dashuri për të s'ka ndjerë?
Si e ka lënë që mbi ujëra e vetme të bredhë?

Ajo doli në breg,
vetëtiu rëra,
mbi trupin e saj,
rrezet rrëshqitën të nxehta.
Mos ka rënë në dashuri me diellin?
Valët klithnin,
një emër thërrisnin,
si s'e pata kuptuar,
se skulptori pas saj ish dashuruar?

Ajo ngriti kokën,
sytë e saj s'vështruan detin,
sytë e saj s'vështruan diellin,
sytë e saj...

31 DHJETOR 1944

Nga flakët e luftës
u dogjën flokët e vitit,
mbi bredhat yje të ndezur ranë.

Kënga për botën e re
malet brodhi,
strehët e kasollevë pikuan lotë gëzimi.

ZEMRA E PAVDEKSHME

(Në shtëpinë ku ra Tosun Shahinasi lindi një fëmijë)

Brenda muresh trokitjet e një çekani,
mes mureve të qeshurat e para të një fëmije.
Fëmija do të rritet mes trokitjesh,
mes rrahjeve të një zemre të pavdekshme.

Trokitje çekani,
trokitje zemre,
midis një heroizmi,
një rënieje,
një lindjeje,
një lidhje e përjetshme.

Brenda mureve ai zemrën punëtore e vendosi,
që sot të dëgjohen të qeshurat e një fëmije.

T H J E S H T Ë S I

Im atë
me karrocë fëmijësh parqeve s'më ka shëtitur.
Mbaj mend
si mbi shilarës,
në duart me kallo lart më ka ngritur.

— T'i shkoqitim gjërat — thotë — shkurt e
qartë.

Isha jetim,
po sot kam fëmijë të lumtur.
Isha gëlqerexhi i këputur,
me gurët digjja jetën.
Sot luftëtar i palodhur
për të vërtetën!

Im atë,
si mikroborgjezi s'filozofon për lumturinë,
gotën me shokët përpjek fytyrëqeshur,
«Gëzuar vëllezër, ditë të bukura vijnë!

PAZARI I KORÇËS



Ec nëpër pazar,
në rrugë të vjetra kurriz deformuar.
Heshtja,
Mbështjell muret e arnuar.
Mbi një ndërtesë,
një punëtor i moshuar në Komunale.
Ndalem
e me të ndez një cigare.

O bir,
në këtë pazar, na janë këputur duart...

Kujtimet
e rrëmbyen punëtorin e Komunales...



Natë,
për njerëz e kafshë hanxhiu
në kthina shtron kashtë.

Të lodhura,
në krevate me dërrasa
shtrihen të mbledhin kockat
vajza e plaka.

Në kovaçanë rradhiten sëpata e kosa,
thika e kasapit klithë nga mprehja,
lakmia e tregëtarit në rafte ngjeshë thasë.

Natë,
mbi një kasolle qeshën hidhur hëna.
Do shesim, do blejmë,
mos shesim, s'do blejmë,
një fëmijë për dhinë qan,
një tjetër qesh.

E shtangur plaka,
dridhen supet e nuses.
Heshtje,... britma
kokën heshtas e ul mënjanë dhia.

Natë.
heshtja e mbërthyer mbi qepena,
natë e ëndrrave të frikshme,
natë, shumë sy si yje të ftohtë të ngrirë.
Natë, nesër është ditë pazari.

Si një pjatë e farfurinjtë
mbi kurriz të Moravës dielli.
Mëngjes.
Qyteti lan fytyrën me ujë tullumbi.
Nga shtëpitë e ulta,
ngarkuar me qilima,
të vogla, të kërrusura me hap të nxituar
plakat.

Hanet e përgjumur,
shkundin supet nga kashta,
të bardha, të hirta në rrugë dynden
bagëtia.

Një fëmijë i dobët rakitik
me një kafaz pëllumbash...
Si perde të dramave të lashta,
ngrihen qepenat,
fillon pazari.

Trotuaret,
rafte të gurtë.
Me shami të lagur fshin djersën e gjalpit
fshatari.

Çirren plakat,
me lulet e lkuqe,
shesin sytë, gishtrinjtë e hollë,
rininë e humbur të vajzave.

— Ej, pasqyra, gravata,
bërtet një kurbat, me krahë të hollë,
të zeza, të gjata.

Klithma bagëtish.
Fryhet e çfryhet kaceku i kovaçit.
Mbi pazar,
një këmbanë zërash të çjerrë,
zëra që ndjellin jetë.
Ajri i pluhurosur, i kripur me djersë.

Mbrëmje,
në hane,
në kthina sa një kamare,
tretet një flakë e zbehtë vaji,
shtrirë mbi kashtë mendon fshatari:
Si u derdh kështu papritur,
nëpër rrembat e pazarit qumështi
i fëmijve?

Pëllitje gomari,
në pijetore të hanit,
gjer në agim si një bretkocë e shëmtuar,
kumari.

Si i pirë,
pas orgjish të çthurura rënkon pazari.
Çakërcejf,
pijnë birrë tregtarët në «Kristali».
Në sobalka,
mes leckash e lesh të larë,
plakat se ç'bëjnë ca llogari nëpër gishta
me vajzat,
zanaçinjtë në ujë të kripur fërkojnë
këmbët e mpira,
çirakët gjysmë vdekur, gjysmë gjallë
mbi dërrasa.

Pazari

zemra e qytetit,
me arterie të shtrembëra të gurta,
me arterie të pluhurosura me baltë.

Damarët e hollë,
nëpër shtigje dhish ngjiteshin në male.
Rrëshqisnin mes arave të grunjta,
nëpër gishtrinjtë e vajzës në avlement,
mes qumështit të bardhë në sisën e nënës.
Dhe thithej gjaku,
nga borgjezë e tregtarë,
dhe kthehej gjaku në argjend e ar.

Deformohet nga dhimbja
baraka e kovaçit.
Fshatari i uritur lëshonte sokëllëmen
në mal,
vajza thinjeje mbi avlemendin-varr.

●

Në qiell hëna si simite,
dielli si bukë qiçre.
Uria kafshonte sofrat e drunjta,
në depot e spekullatorëve,
vunë dhjamë minjtë.

●

Këmishë grisur,
sy palarë pazari,
në qepena mbërthyer ankthi,
u gdhi shtatë prilli.

Para bashkisë,
bijtë e varfër të pazarit duan armë.
Gufon gjoksi i reshkur i Moravës
fryhet i turbullt Devolli,
dyqanet zgjeron për mallra të reja
tregëtari.

Nën qiellin e pushtimit,
dergjen mbi trotuare të pazarit
pianecët.

Në kafenetë,
shahen italisht bixhozxhinjtë,
e qeshura e prostitutës
pranë monologut të ftohtë
të bajonetës.

Barakat s'kanë gjumë,
kokën njëra mbi tjetrën mbështesin
si njerëz në rradhë për bukë,
presin diçka të ndodhë.
Në kovaçanë
mbi kudhër duar punëtorësh
mbledhur grusht.

Muskujt e rrugëve u thurrën,
fytyra e rrudhosur e qytetit të mplakur
e kuqërremtë.

Gjoksi i tij brinjëdalë,
një me gjoksin e maleve.

Zhurmezat u shuan,
(thirrjet e tregëtarëve, tingujt
e këmbanave)

Zëri i revolucionit,
ndau në mijëra copa qetësinë e vjedhur
të borgjezëve.
Zverdhje fytyre, dridhje trupi
në fyt gishtrinjtë të hollë, të fortë,
ankthi.

Liri!
Buçet me zë të fortë kovaçi
Liri!
I hutuar
kapelaxhiu vërtit kapelen në duar:
Do i shterren hallet fukarasë?

— Shokë! Rroftë Partia! —
S'përmbahet Koci Bako.
Morava fjalët i rrëmben,
Me erën i përcjell në thellësi të Gorës, të Oparit.
— Rroftë Partia! —
Avuj gëzimi nga mushkëritë
e fushës së Devollit.

— Rroftë Partia! —
Luftëtari kombëtar kërkon të shkëputet
nga piedestali,

●

Bijtë e varfër të pazarit,
iu ngjiten të përpjetës thikë të malit,
drejt diellit.

Kovaçi,
braktisi kacekun që mezi ngopej me frymë,
në duart e tij e lehtë pushka,
në sobalka,
plakat thurnin bluzët e leshta,
netëve ilegale,
Vajzat me shokë ngjithnin mureve trakte.

●

I përgjakur,
dielli mbi kurriz të Moravës.
Para portave të drunjta,
plakat me shami e përparëse të reja,
vajzat me trendafille të kuq në buzë e flokë
lajnë oborret e gurta,
nënat e urta me duar të dridhura,
shtrojnë qilima në dhomat e mira.

Në rrugë,
vogëlushet lëshojnë pëllumbat e bardhë,
këngën e çlirimit këndojnë të mallëngjyer.

Qyteti,
flaku nga flokët e thinjur shaminë
e zezë të pushtimit,
buzë pazarit,
U hapën për kombinatë modernë
themelitë.

Kovaçi hyri punëtor në uzinë,
vajzat braktisën avlëmendet,
me basmat e kaltërta endin lumturinë.

SHTIGJEVE TË MUSHKËS

Shtegu i ngushtë i mushkës,
shtegu i jetës,
shtegu më i vjetër, ku zenë rrënjë udhët e kohës.

E gjatë udha e shqiptarit,
udhë me gjurmë

hapash të sigurta, të pasigurta,
hapa të matura buzë greminës,
hapa që shkonin herë para, herë mbrapa,
hapa të mëdha që kapërxyen shkëmbinjtë,
hapa revolucioni që gjëmojnë udhës së
historisë.

E gjatë udha e shqiptarit
udhë e përgjakur,
udhë e dhimbjes dhe e krenarisë,

udhë e djersës së ndershme,
udhë e lavdisë më madhështore, më modeste.

Udha e shqiptarit,
në dy pjesë e ndarë,
në shtigjet e dhimbjes, shtigje ndriçuar
me pishtarë,
dhe në udhët
e autobuzëve urbanë,
të trenave, të avioneve,
udhë ngarkuar me heroizmin,
udhë të revolucionit,
të luftës për komunizmin.

Koha
e përplasi shqiptarin mbi shkëmbinjtë,
ku ka më tepër borë se blerim,
ku ka më tepër thëllim e ngricë.
Shqiptari u mblodh si gur i fortë
në ashpërsinë e malit.

Përmes gurëve të shtëpisë,
frynte shpesh një erë e ftohtë e varfërisë,
të qarat e fëmijës, përziheshin me hingëllimën
e mushkës,
sëpata lëshonte sokëllimën

Shtegu i ngushtë i mushkës,
shtegu i jetës,
nëpër atë shteg çapitej me mundim
mushka kockë e lëkurë.
I thatë e kokën lart pas saj malësori.
Një vandak drush mbi samar,
një grusht misër,
një grusht jetë,
në sytë e rreptë,
fytyra e zbehtë e fëmijës.

Dridheshin

këmbët e mushkës mbi kalldrëmin e rrugëve,
binin patkonjtë asfalteve,
me dhimbje buçiste malësori:
— Dru..., heej,... dru..., pishë,.. pishë! —
Kjo thirrje për jetë,
të dukej sikur malësori çvishte
nga trupi lëkurën,
druri dhe pisha për të ishin dhe zjarr
dhe dritë
— Dru..., heej,... pishë,... pishë! —

Në prag të vjeshtave të verdha,
kur rakia zihej dy herë nëpër kazanë,
nga malet për matanë
vinin nuset e reja.

Vinin,
nëpër shtegun e mushkës,
shtegun e gëzimit,
shtegun e hidhërimit.
Nuset qanin pa zë,
me kokën nën duvakun e mjerimit.

Dridheshin supet prej ngashërimit,
dridhej trupi i mushkës.
Krushqit këndon çakërcejf,
kafsha ndalej dy çape buzë greminës.

Kështu mbartej jeta,
nëpër shtegun e ngushtë dredha-dredha,
mbi këmbët muskuloze,
mbi kurrizin e fortë të mushkës nervoze.

Shpesh
shtegu i jetës zihej nga bora,
malet zhyteshin ndër mjegulla,
malësori dhe mushka,
mbeteshin të vetëm, nën ironinë
e ftohtë të kohërave.

Të vetëm,
i vetmuar,
me grushte e shpatulla,
çante dëborë e mjegulla bashkë.
Një hap, dy, tre hapa,
rrutullohej në vend, kthehej prapa
e prapë ecte... ecte...
Trupi i përgjakej,
 gjoksi i çahëj... ecte...
Mes shkëmbinjve të thepisur
 e gjente shtegun e jetës,
shtegun e mushkës,
shtegun që kalonte tmerrësisht buzë greminës.

Rrëzë maleve
përjetësisht lumenj të kulluar kanë rendur,
duke shkelur mbi gjurmët e mushkës,
 shqiptari është menduar:
Do të vijë dita vallë,
kur shtegu do të zgjerohet sa shtrati
 i lumenjve të bardhë,
kur jeta të mos kërrusej si mushka,
kur malet të mos thaheshin nga uria,
dhe udhët e jetës të mos ziheshin
 nga bora?

Çapitej
shqiptari ngadalë pas mushkës,

duke shkoqitur filozofinë e dhimbjes,
filozofinë e përpjekjeve shekullore për liri,
filozofinë e jetës së ndershme,
filozofinë e shpatës së përgjakur për
drejtësi.

Shteg i ngushtë i mushkës,
shteg i përbaltur e me gurë,
arter i përgjakur që ngjitet në male,
shteg ku të zbarthur e heroikë
u ngjitën vitet partizane.

Dhe erdhën stinë të reja,
stinë të rrëzimit të ortekeve të borës shekullore,
stinë të gremisjes së mjegullës ndër humnera,
stinë të çeljes së udhëve të gjëra.

Nuk ishte e lehtë çelja e udhës,
e udhës që kërkonte shembjen e kullës
bajraktare,
e udhës që kërkonte shembjen e kullës fetare,
shembjen e grindjeve, të hakmarrjeve,
shembjen e vjetërsirave patriarkale.

Po shqiptari tani dinte, ku të drejtojë plumbin,
dinte ku të vendoste minën,

u mësua të ëndërrojë,
të shohë qartë perspektivën.

Shqipëria
braktisi shtigjet e ngushta,
Shqipëria ecën
në udhën që prek horizontet e ndritura!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	faqe
<i>Vjersha</i>	
Portreti i Shqipërisë	3
Për mëmëdhenë s'heshti kitara	5
Duajini ata sy fëmije	7
Fjala e plakut borovar në ditën e djegies së Borovës ..	8
Eterve te thinjur	11
Qilimi	12
Atje ku u tretën ëndrrat vajzërore	14
Vajza e piktorit	16
Të dy shtegtarë	18
Të ka ardhur nëna	19
Mbrëmë	20
Fjala e shoqes sime për buzëqeshjen	21
Mos harroni këngën e zogjve	22
Nëna partizane	24
E qeshura e hidhur	25
Ti, qyteti i studentave	27
Fjalë për babanë punëtor	28
Kur qep ngjyrat e ndezura	29
Euforia	30
Me rrobën e blertë para familjes	31

Buzë detit pranë dashurisë	33
31 Dhjetor 1944	34
Zemra e pavdekshme	35
Thjeshtësi	36

Poema

Pazari i Korçës	37
Shtigjeve të mushkës	47